

BOGA

Turizmi në zonën e Boges ka patur një zhvillim të hershëm dhe është frekuentuar nga qytetarët e Shkodrës dhe klerikët katolikë që vinin këtu në periudhën e verës. Natyra e kësaj zone, pozita gjeografike e saj, e bëjnë këtë zonë lakmuese për ofertën turistike që paraqet.

Vlen për tu theksuar se zona e Bogës dhe rrethinat përreth saj, ka traditë në fushën e prodhimeve blegtorale, të artizanatit, të prodhimeve artistike me dru me karakter kombëtar të cilat e pasurojnë dhe e bëjnë më të larmishme tregun e produktit turistik të kësaj zone. Po ashtu popullsia e kësaj zone trashëgon traditat më të mira të tilla si: mikpritjen, besnikërinë, bujarinë dhe vlera të shumta morale.

Duke qënë se në afërsi të kësaj zone ndodhen edhe pika të tjera turistike siç është ajo e Razmës dhe e Thethit, ndërthurja e këtij destinacioni me zonat përreth në paketat turistike, përbën një mundësi më shumë zhvillimi të turizmit qoftë atij familjar dhe turizmit të interes të veçantë.

RRUGA PËR NË BOGË

Boga ndodhet në pjesën e sipërme të përroit të thatë rreth 48 km në veri të qytetit të Shkodrës dhe vetëm 37 km larg qytetit të Koplikut. Rruga për në Bogë bëhet kryesisht nga segmenti Shkodër – Koplik - Bogë. Rruga është e asfaltuar dhe me furgon kushton 800 lekë. Udhëtimi për në Bogë zgjat rreth 5 ore.

NATYRA

Lugina e Bogës, që për nga origjina është akullnajore, ka formën e një rrethi ku malet që e rrethojnë formojnë kolona me lartësi mbi 2000 m. Nga malet që e rrethojnë, kur shkon për në Boge, nga e djathta shtrihet maja e Rabës (2222 m), vazhdon më tej me malin e Cardakut (2250 m) dhe me majën e Shtegut (2083 m) ku lidhet me malin e Radohinës dhe me malin e Arapit që e ndajnë nga lugina e Thethit, ndërsa në krahun e majtë, shtrihen mali i Pultinzes, më pas mali i Dragomirit, mali i Bridashës (2187 m) e pastaj maja e Vuklin ku lidhet me Radohinën.

Boga për arsye të karstit ka shumë shpella dhe galeri nëntokësore të cilat i plotësojnë kërkesat e eksploratorëve të ndryshëm duke ia shtuar vlerat turistike kësaj zone. Origjina akullnajore e Bogës e bën këtë vend të veçantë, fundi i luginës që është 700 m mbi nivelin e detit dhe majat mbi 2000 m lartësi, ajri i pastër, uji i ftohtë, peisazhi alpin e malor, të gjithë këto janë të veçanta, të rralla dhe mbi të gjitha janë mjaft atraktive për zhvillimin e turizmit.

Nje rol të vecantë për një ajër të pastër e të pasur me oksigjen, si dhe për krijimin e një mikroklima me vlera për Bogën kanë luajtur e luajnë masivet e pyjeve drunorë (të Aheve, Bredhave etj.), si dhe bimësia (një vjecare) që lulëzon në stinët e Pranverës, Verës e Vjeshtës, në Luginën, shpatet dhe majat e maleve që e rrethojnë. I gjithë ky gjelbërim është një mrekulli piktoreske e Natyrës.

Përveç bukurive natyrore që lugina e Bogës ofron me bukuri alpine, pesiazhet shkëmbore, pyje lëndina, mund të përmendin relievin karstik që është shumë i theksuar dhe i shprehur me një numër të madh të shpellave dhe galerive karstike. Shpërndarja e

shpellave karstike është e larmishme dhe me interes shkencor dhe turistik. Ndër shpellat kryesore mund të përmendim:

Shpella e Puçit është shpella më e madhe në Shqipëri dhe ndodhet në të djathtë të majës së çardakut, kjo shpellë shkon deri në 200 m thellësi, vazhdon me një galeri të gjatë që shkon deri në 1 km dhe përgjatë saj gjenden disa puse, në fundin e së cilës rrjedh edhe një perrua i vogël.

Shpella e Husit, gjendet pranë asaj të Puçit. Edhe kjo shpellë ka shumë galeri me një thellësi mbi 130 m por për arsye të dëbores dhe akullit të përjetshëm që permban nuk ka qenë i mundur eksplorimi i plotë i saj. Ndër shpella të tjera përmendim gjithashtu: **Shpella e Gjek Markut, Shpella e Silikokave, Shpella e Zanave** e cila ka një pjerrësi në zhytje dhe **Shpella e Madhe**.

Klima

Temperaturat gjatë muajve të Dimrit janë fare normale për një vend malor si Boga, ku minimalja zbret vetëm për pak ditë nën minus 6 apo rradhë minus 8 gradë nën zero. Temperaturat në Verë janë disi të “përziera” mesdhetare-kontinentale. Maksimalja e temperaturave gjatë ditës në muajin Korrik nuk i kalon kufinjtë e 19-20 gradëve, ndërsa natën temperatura mesatare kap vlerat 12-15 gradë celcius. Gjatë muajve Qershor apo Gusht temperaturat gjithnjë kanë shënuar vlera më të ulta. Rreshjet në Bogë kanë një mesatare vjetore rreth 1900 deri në 2100 mm (rrjeshje), ku bie në sy një shpërndarje më e “drejte” për stinën e Verës, gjë që ka influencuar në rritjen e lagështirës ajrore dhe freskisë për muajt e nxehtë.

Flora dhe Fauna

Flora dhe fauna është shumë e pasur dhe shquhet për biodiversitetin e saj të lartë. Përgjatë luginës së Bogës takohen këto kate bimore që janë: shkurret ku mbizotëruese është lajthia dhe dellinja. Kati tjetër është ai drunjëve të lartë ku mbizotëruese është ahu dhe kullota alpine. Në këtë zonë po ashtu mund të gjejmë bimë endemike të rralla si: Eulfenja e Baldacit, që gjenden në shteg të dhenve, në qafë Shtogu si dhe Crekus i Dalmacisë që gjendet në Bjeshkët e Namuna, Radohinë etj. Fauna gjithashtu është e pasur ku ka mbi 25 lloje gjitarësh, të tilla si: dhia e egër, macja e egër, vjedulla e zardafit dhe mbi 40 lloje shpendësh ku nga këto janë të rralla: gjeli i egër, shgiponja e malit dhe pula e pyllit.

DISA ASPEKTE HISTORIKE

Boga ka një histori jete prej qindra apo mijëra vitesh. Në trojet e Bogës janë gjetur deshmi arkeologjike të vendbanimeve të hershme Ilire, (të kohës “romake” fundi i shekullit II, shekulli III mbas lindjes së Krishtit). Sipas arkeologut të njohur Skender Anamali në; Tumulin Koder Boga janë gjetur: Një unazë ari, karfica argjendi, dy monedha: një e perandorit romak Setimo Severi dhe një e Maksimilan Darës. (“Drita”, Cështja e Tumave ... viti IV i botimit nr. 8-9). Kjo histori sot përvet dokumenteve (të shkruara në libra etj. nga studiues të ndryshëm), ka ardhur deri në ditët tona edhe nëpërmjet gojëdhënave të trashëguara nga banorët autokton të Bogës. Boga,

grup - vendesh në Luginën e Sipërme të Përronit Thatë, të vendosura në lartësinë 900 – 1000 m nivelin e detit. Banorët i përkasin fisit të Kelmendit të zbritur në luginën nga vendbanimet fillestare të Cemit. Famullia (arkidioqeze e Shkodrës) e themeluar kohët e fundit (gjysma e dytë e shekullit XIX, N.B.) dhe Kisha famullitare gjenden në Precaj, në qendër të flamurit ose bajrakut të Bogës. Boga si vendbanim njihet të paktën që në shekullin e XV. Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, fq.128 (përpiluar nga pushtuesi Otoman për qëllime taksash) e regjistron Bogën si fshat me 2 shtëpi, dhe të përfshirë në Nahijen (Komunën) e Pipërve. Ndërsa një burim tjetër tregon se Boga kishte tetë shtëpi dhe të gjitha ishin të besimit Kristian. (Përparime Huta, Fshati në Sanxhakun e Shkodrës në shekujt XV-XVI, fq.152). Në organizimin e Bajraqeve (fundi i shekullit XVII), Boga shkruhet se është një ndër katër bajraquet e Kelmendit. Sipas gojëdhënave Boga ishte emri i djalit të dytë të Klementit (të parit të Kelmendit). Nga djali i dytë rrjedh fisi i vogël i Bogës, që bënë pjesë në Fisin e Kelmendasve, dhe është vendosur ndërmjet maleve të Shkrelit, Kastarit, Shalës dhe Kelmendit. (Hyacinthe Hecquard; Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë, fq.181.).

AKTIVITETE

Në Bogë është e mundur të zhvillohen sporte natyrore sic është alpinizmi i cili mund të aplikohet me ngjitje në majat që janë përreth kësaj zone. Larmia e relievit krijon mundësi për ngjitje alpine të kategorive të ndryshme si për fillestarë ashtu edhe për profesionistë. Shtrirja e majave me lartësi mbi 2000 m në këtë zonë i jep mundësi zhvillimit të alpinizmit sidomos me malin e Rabë.

Ndër sportet e tjera që mund të zhvillohen janë: Gara me kuaj (hipizëm), shëtitje me biçikleta (këto mund të zhvillohen në pjesën e sipërme të luginës në fushën e Okolit), sporti i gjuetisë etj.

Për zhvillimin e sportit të skive, nuk plotëson kushtet e nivelit të lartë, por për pista amatore ka vende mjaft të përshtatshme.

Kjo zonë ofron interes të veçantë gjithashtu edhe për zoologët, sepse numri i shpendëve dhe kafshëve të egra është mjaft i madh si në lloje ashtu edhe në sasi. Në këtë zonë mund të gjenden nga llojet e shpendeve thellënza e malit, shqiponja e malit, shepka, gjeli i egër, pula e pyllit, pëllumbi i egër dhe mullizeza. Nga kafshet mund të gjenden dhia e egër, derri i egër, ujku, vjedulla, dhelpra, macja e egër etj.